



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FShMN

Ref. nr. 2820

Prishtinë, Dt. 03/09/2025

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMËS  
MASTER

FAKULTETI	FShMN
Departamenti/ Programi	Fizikë
Projektpropozimi	Përdorimi i simulimeve FLUKA për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë (QA/QC) në radioterapi
Kandidati/ja	Eros Halili
Mentori	Prof. Asoc. Gazmend Nafezi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 24.04.2025
	Vendimi nr. 1308

Dorëshkrimi i kandidatit Eros Halili fillon me hyrjen, që paraqet edhe kapitullin e parë të punimit, ku tregohet për rëndësinë e një hulumtimi të këtij lloji.

Materiali në kapitullin e dytë përmban aspektin teorik të punimit, duke filluar me bazat e fizikës së rrezatimit; radioaktiviteti, bashkëveprimi i rrezatimit me materien (efekti fotoelektrik, efekti i Komptonit dhe prodhimi i çiftit elektron – pozitron) si dhe konceptet themelore dozimetrike që përfshijnë dozën e absorbuar, dozën ekuivalente dhe dozën efektive.

Kapitulli i tretë "Planifikimi i trajtimit", përshkruan hapat esenciale për planifikimin e trajtimit në radioterapi, duke përfshirë marrjen e të dhënave të pacientit, përcaktimit e vëllimeve të targetit, përshkrimin e dozës, teknikat e ndryshme të trajtimit si dhe radiobiologjinë e tumorit.

Kapitulli i katërt "Siguria dhe kontrolli i cilësisë në radioterapi", diskuton rëndësinë kritike të protokoleve të sigurisë dhe kontrollit të cilësisë në radioterapi, nevojat dhe kërkesat, aksidentet, ekipin multidisiplinar si dhe programet QA për akseleratorët linearë.

Kapitulli i pestë detajon metodologjinë e implementuar në punim, duke përshkruar konfigurimin e simulimeve FLUKA, përzgjedhjen e parametrave si dhe gjeometrinë e problemit për tufat e elektroneve.

Në kapitullin e gjashtë paraqiten rezultatet e punimit, duke përfshirë krahasimin e lakoreve PDD të FLUKA-s dhe Linac, shpërndarjen e gabimit relativ dhe absolut, profilin e dozës si dhe shpërndarjen 2D të dozës.

Kapitulli i shtatë "Diskutim" interpreton rezultatet, diskuton implikimet dhe kufizimet, si dhe ndërlidh gjetjet e punimit me literaturën ekzistuese dhe praktikën klinike.

Seksioni "Konkluzion" përmbledh gjetjet kryesore, thekson rëndësinë e hulumtimit dhe sugjeron hapa të ardhshëm për avancimin e përdorimit të simulimeve FLUKA në radioterapi.

Prandaj, duke u bazuar në përshkrimet e dhëna më lartë, dhe pas analizës së tërë materialit të punimit, komisioni për vlerësim të dorëshkrimit dhe mbrojte të temës master, bazuar në Kërkesën nr.2616, të datës 22.08.2025 për temën "*Përdorimi i simulimeve FLUKA për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë (QA/QC) në radioterapi*" të kandidatit Eros Halili, në përputhje me procedurat e rregullores së studimeve master, paraqet këtë:

#### **Vlerësim të dorëshkrimit**

Kandidi Eros Halili, temën e nivelit master e ka shkruar në përputhje me kriteret akademike dhe të parapara me rregullore. Tërë materialin e ka shtri në 60 faqe, të sistemuar në 7 kapituj. Materialit i paraprinë: abstrakti, hyrje, përmbajta, lista e tabelave, lista e figurave dhe lista e shkurtesave, ndërsa përfundon më referencat. Kandidati në hulumtim ka shfrytëzuar një numër të konsiderueshëm të literaturës aktuale, ndërsa për shtjellim të temës ka ndërtuar tabela dhe figura të shumta. Formulatat, tabelat dhe figurat janë kompatible me tekstin. Shtrimi dhe shtjellimi i temës është në përputhje me normat pedagogjike dhe hulumtuese.




Komisioni mendon se me qëllim të rritjes së kualitetit të punimit, kandidatja duhet të bëjë edhe këto përmirësime:

1. Kapitulli 4 duhet të jetë: Materiali dhe Metodat.

2. Figurat duhet të përmenden qartë në tekst dhe përshkrimi adekuat.
3. Tek "Rezultatet", figurat të cilat janë në lidhshmëri, si a) dhe b), mundësisht të jenë në faqe të njëjtë.
4. Të shihet për gabime teknike dhe gjuhësore

Prishtinë, 03.09.2025

**Komisioni:**

1.   
/ Prof. Dr. Naim Sylja – kryetar/
2.   
/ Prof. Asoc. Fisnik Aliaj – anëtar /
3.   
/ Prof. Asoc. Dr. Gazmend Nafezi – anëtar  
(mentor)/